

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, BASHKIA VLORË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vlorë, me objekt “Mbi realizimin e të ardhurave vendore dhe zbatimin e legjislacionit për programimin dhe vjeljen e taksave vendore” për periudhën 01.01.2012 – 30.09.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 174, datë 23.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 836/7, datë 23.12.2014, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar z. Shpëtim Gjika Kryetar i Bashkisë, Vlorë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave vendore nga taksat dhe tarifat për periudhën objekt auditimi rezultoi se buxhetit të Bashkisë Vlorë i mungojnë të ardhura në shumën prej 402,195 mijë lekë si rezultat i mosrealizimit të planit të të ardhurave, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 12-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë për DTTV, Bashkia Vlorë, është rekomanduar që të marrë masa riorganizimi për të përmirësuar punën në të ardhmen nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit midis sektorëve dhe hallkave të tjera të njësisë, me qëllim rritjen e efektivitetit të punës kontrolluese nga specialistët e kontrollit në terren dhe specialisti i menaxhimit të borxhit të keq nëpërmjet përgatitjes së programeve periodike të punës për mbledhjen e të ardhurave dhe menaxhimin e borxhit të keq.

Menjëherë

2. Të ardhurat nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme janë realizuar më pak se programimi në shumën prej **136, 639 mijë lekë**, të cilat kanë krijuar një efekt financiar negativ në të ardhurat e buxhetit të qeverisjes vendore, Bashkia Vlorë. Ato kanë ardhur kryesisht nga mungesa e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit sidomos me ZVRPP, gjendjen civile dhe Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, pasi nuk kanë përgatitur dhe nuk disponojnë asnjë regjistër manual apo elektronik me të dhëna të plota të pasurive të paluajtshme (ndërtesat) në përdorim të bizneseve apo të familjarëve, që gjenden në juridiksionin e Bashkisë Vlorë, *trajtuar më hollësisht në faqet nr.12-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë për DTTV, Bashkia Vlorë, është rekomanduar që të marrë masa për sigurimin e të dhënave të nevojshme nga ZVRPP, apo nëpërmjet komisioneve të ngritura nga Organet e pushtetit vendor për verifikimin e pasurive të paluajtshme, për plotësimin e dokumentacionit ligjor dhe të përgatisë regjistrat bazë për llogaritjen, evidentimin dhe arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga taksa e pasurisë mbi ndërtesat në përdorim të subjekteve të biznesit dhe të familjarëve.

Në Vijmësi

3. Nga auditimi i dokumentacionit mbi arkëtimin e lekëve nga faturistët rezulton se të gjithë faturistët e rajoneve nuk i kanë arkëtuar lekët e mbledhura nga pagesa e taksës së banesave dhe tarifave familjare të shërbimit në fund të ditës në bankë, por i kanë depozituar ato në kasafortat e tyre në ruajtje në rajon (sipas deklarimit) jashtë limit të arkës dhe kushteve të ruajtjes së tyre, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 36-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë për DTTV, Bashkia Vlorë, është rekomanduar që të nxjerrë një urdhër të brendshëm të miratuar nga Kryetari i Bashkisë, për sigurimin e kushteve dhe administrimin e lekëve të arkëtuara nga faturistët gjatë ditës së punës, për të shmangur abuzimet.

Menjëherë

4. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk ka bërë përpjekjet e duhura në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, për të rritur dhe fuqizuar nivelin e bashkëpunimit me agentët tatimor të përcaktuar me ligj si; Z.V.R.P.P, D.R.SH.T.RR, ALUIZNIN dhe D.T.R, Vlorë, por edhe për krijimin e agentëve të rinj lokal si; KESH apo UK, me miratimin e Bashkisë, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 64-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të kërkojë nga bashkia Vlorë që taksat e ndërtesave të banimit dhe tarifa e shërbimit për ndriçimin, pastrimin dhe gjelbërimin e qytetit të arkëtohen nga agentë e rinj lokal si **KESH apo UK**, duke nënshkruar marrëveshje të posaçme bashkëpunimi ku të jenë përcaktuar sanksione për secilën palë, të cilat do të mund të sigurojnë rritjen e efektivitetit të zbatimit të ligjit dhe realizimi i të ardhurave është më i garantuar.

Menjëherë

5. Detyrimet debitoare (borxhi i keq), nga viti në vit kanë ardhur në rritje të pandërprerë kështu në vitin 2013 borxhi i keq është rritur me shumën **90,780 mijë lekë** ose në masën **40 %**, i cili ka ardhur kryesisht si rezultat i mos zbatimit të masave ligjore përfshi vendosjen e sekuestros ekzekutive e deri tek konfiskimi i mallrave, për rikuperimin sa më të shpejtë të borxhit të keq, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 57-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë për DTTV, Bashkia Vlorë, është rekomanduar që nëpërmjet specialistit të menaxhimit të borxhit të keq, të marrë masa me qëllim rikuperimin e pandërprerë të detyrimeve debitoare gjendje, e cila më datë 31.12.2012 paraqitet e analizuar, me 1664 subjekte për 3932 raste (taksa e tarifa) **në vlerë 132,840 mijë lekë**, ndërsa për vitin 2013 me 2357 subjekte për 4731 raste (taksa e tarifa) **në vlerë 227,626 mijë lekë** të ardhura të munguara.

Menjëherë

6. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vlorë për periudhën e audituar kishte programuar për të mbledhur nga taksa familjare e ndërtesave të banimit dhe tarifa e shërbimit për pastrimin, ndriçimin dhe gjelbërimin e qytetit **218,824 mijë lekë** të ardhura gjithsej, nga të cilat ka arkëtuar vetëm **24,313 mijë lekë**, ose në masën **12 %** ndërsa në buxhetin e qeverisjes

vendore, Bashkia Vlorë kanë munguar për gjatë kësaj kohe **194,511 mijë lekë të ardhura**, të cilat nuk janë kontabilizuar si borxh i papaguar, për mungesë të egzistencës së regjistrave përkatës dhe të listave emërore të kryefamiljarëve, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 36-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë për DTTV, Bashkia Vlorë, është rekomanduar që të bëjë regjistrimin e abonentëve familjarë nëpërmjet listimit manual apo elektronik, për të cilët nuk janë evidentuar detyrimet e papaguara për taksën e ndërtesës së banimit dhe tarifën e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit të qytetit, për vitet 2012, 2013 dhe 9 mujorin e vitit 2014, të saktësojë vlerën e munguar si diferencë ndërmjet programimit dhe realizimit në fakt **prej 194, 511 mijë lekë**, të hartojë njoftim vlerësimit përkatës për detyrimet e lindura dhe të marrë masa për arkëtimin e tyre, në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

Në Vijmësi

7. Sektori i Kontrollit dhe Sekuestros, gjatë ushtrimit të detyrave funksionale, nuk ka kryer kontrole të plota për mbledhjen e të ardhurave dhe rikuperimin e borxhit nga subjektet e ndryshme të biznesit, si dhe nga abonentët familjarë, mungesa e të cilave ka ndikuar drejtë përsë drejti në uljen e nivelit të arkëtimit të të ardhurave, si dhe mos përmirësimin e nivelit të rikuperimit të borxhit të keq, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 66-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë për DTTV, Bashkia Vlorë, është rekomanduar që të marrë masat e duhura organizative, të përgatisë dhe të miratojë për Sektorin e Kontrollit dhe Sekuestros programe pune të posaçme me afate kohore të përcaktuara saktë dhe në përfundim të kontroleve të analizojë dhe të miratojë rast pas rasti raportet e përgatitura nga kontrollorët në terren dhe të përcaktojë masa konkrete, për realizimin e të ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore.

Menjëherë

B. MASA PER SHPERBLIM DEMI

Nga DTTV, Bashkia Vlorë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rru gë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **165,110 lekë**, nga 6 subjekte, *trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit faqe 36-57*, për mos llogaritjen dhe mos arkëtimin e detyrimeve të lindura nga taksa e pasurisë së ndërtesave në përdorim të bizneseve, për periudhën viti 2012 – 30.09.2014.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Vlorë, që në vlerësim të shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të bëjë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien

e masave disiplinore, sipas VKM nr. 115, datë 05.03.2014 dhe ligjit nr. 152/2013, për nëpunësit civil të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vlorë.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Livan Hoxha, p/grupi, Anesti Gjika dhe Vladimir Rizvani, u mbikëqyr nga Kryeauditues z. Albert Thoma, më tej u shqyrtua nga Drejtori i Departamentit zj. Albana Agolli dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm znj. Luljeta Nano.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

Bashkia Vlorë nuk ka kthyer ende përgjigje për masat e marra në zbatim të rekomandimeve.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT